


AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR
(ASIG)

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

RAPORT PËR INSTITUCIONET E VARËSISË

Përmbajtja

RAPORT PËR INSTITUCIONET E VARËSISË	1
I. Objektivat 2023.....	1
Aktivitetet e realizuara	2
II. Problematikat e evidentuara	7
III. Objektivat Viti 2024	8

I. Objektivat 2023

Për vitin 2023, ASIG ka identifikuar dhe planifikuar realizimin e objektivave të përgjithshme si më poshtë:

- Mbarëvajtja e projektit “Shërbime Satelitore” në kuadër të Monitorimit të Territorit me Teknologji të Avancuar.
- Përpunimin, analizimin e të dhënave të informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë etj., si dhe shpërndarjen e informacionit të përpunuar, për autoritetet publike, sipas fushave të tyre të përgjegjesisë.
- Ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i KRGJSH-së si sistem referues gjeodezik i saktësisë së lartë dhe i unifikuar me sistemin evropian, në funksion të realizimit të punimeve gjeodezike dhe hartografike sipas standardeve bashkëkohore.
- Krijimi i GIS-it Kombëtar dhe funksionimi i Gjeoportalit Kombëtar, për të ofruar informacion gjeohapësinor të përditësuar dhe me standarde në funksion të vendimmarrjeve të drejta për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore ekzistuese dhe krijimi i të dhënave të reja për temat e gjeoinformacionit, veçanërisht i hartës bazë, në përputhje me standardet e miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Sigurimi dhe menaxhimi i burimeve financiare (nga buxheti i shtetit dhe financimet e huaja), menaxhimi i burimeve njerëzore dhe sigurimi i shërbimeve mbështetëse për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të institucionit për të garantuar input-et e nevojshme për realizimin e objektivave teknike të tij.

Për përmbushjen e objektivave të mësipërme, për vitin 2023 nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), janë realizuar detyrat nga drejtoritë përkatëse si më poshtë:

Aktivitetet e realizuara

- Në kuadër të projektit “Shërbime Satelitore” të Qeverisë Shqiptare me kompaninë Amerikane “Satellogic”, në datën 03.01.2023, janë lançuar në hapësirë satelitët Albania-1 dhe Albania-2. Pas një periudhe kolaudimi të orbitave ku do të lëvizin satelitët, si dhe të sensorëve që do të përdoren për mbledhjen e imazheve satelitore, në datën 19.01.2023 ka filluar fotografimi i territorit të Shqipërisë dhe marrja e imazheve satelitore me rezolucion 70 cm sipas zonës së interesit.
- Nga 523 mundësi mbledhje të imazherive nga Satelitët, janë publikuar 378 imazhe satelitore, duke realizuar mbulimin i zonës së interesit për vitin 2023. Nga ASIG është realizuar kontrolli dhe pranimi i produkteve të shërbimit satelitor për 360 imazhe satelitore ku përfshihen: Kontrolli i saktësisë horizontale (RMSE) për çdo imazh satelitor; Kontrolli i secilit element për çdo skedar të imazheve satelitore që merren në dorëzim, si dhe hartimi i raporteve dhe statistikave për ecurinë e projektit "Shërbimi Satelitor".
- Realizuar lista e produkteve për institucionet përfituese të projektit “Shërbime Satelitore”.
- Janë realizuar takime, trajnime dhe workshope për 12 institucione (24 specialistë), me qëllim për t’i njohur me ecurinë e projektit, si dhe ngritjen e kapaciteteve teknike si më poshtë:
 - Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
 - Drejtoria e Përgjithshme e MZSH
 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit
 - Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
 - Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
 - Agjencia Shtetërore e Kadastrës
 - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
 - Inspektoriati Shtetëror i Mbrojtjes së Territorit
 - Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
 - Agjencia e Manaxhimit të Burimeve Ujore
 - Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
- Krijimi dhe shpërndarja e hartave tematike për vlerësimin e dëmeve të zonave të prekura nga zjarri në Peshtan dhe Pishë-Poro të Fierit, në mbështetje të AKMC.
- Ndërtimi i platformës “Modul Editor-it” në Gjeoportalin Kombëtar, i cili do të ndihmojë institucionet e interesuara për përcaktimin sa më lehtë dhe të organizuar të zonave të interesit për produktet e projektit. Për secilin institucion ASIG ka shpërndarë kredencialet e aksesimit të platformës.
- Është krijuar një web app dhe një webmap nëpërmjet të cilave shpërndahen produktet hartografike nga analizimi i imazheve satelitore, për zonat e interesit sipas kërkesës të QTTB për Bashkitë: Roskovec, Berat, Dimal, Mallakastër, Kuçovë.

- Mbulimi me fotografi 360 gradë të gjeoreferuara, të cilat shërbejnë për monitorimin dhe identifikimin e situacionit të infrastrukturës rrugore në Republikën e Shqipërisë. Në total janë mbuluar rreth 1570 km infrastrukturë rrugore në territorin e Republikës së Shqipërisë. Të dhënat janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar
- Realizuar projekti “Ndërtimi i Kornizës Referuese Gjeodezike, FAZA III”, i cili ka si qëllim për herë të parë llogaritjen e Gjeoidit në RSH. Janë implementuar me sukses aktivitetet e mëposhtme:
 - Ndërtimi i 300 pikave të KRGJSH në gjithë territorin e RSH;
 - Realizimi i matjeve GNSS dhe matjeve Gravimetrike Relative;
 - Llogaritja dhe Validimi i gjeoidit Gravimetrikë: ALB – Geoid 2023 V.1.
- Realizuar monitorimi dhe verifikimi permanent i funksionimit të stacioneve ALBCORS, të rrjetit gjeodezik aktiv të KRGJSH-së për 27 stacione referencë, përgatitje e dokumentacionit dhe raporteve periodike.
- Realizuar menaxhimi dhe monitorimi i qendrës së rrjetit të stacioneve Mareografikë, si dhe janë realizuar matjet GNSS në pikat e kontrollit të stacioneve Mareografik, gjithashtu janë llogaritur MSL e të katërt Mareografeve (2018 – 2023).
- Ka përfunduar përgatitja e specifikimeve teknike për mirëmbajtjen e Rrjetit Gjeodezik Aktiv ALBCORS, për periudhën dy vjeçare (Janar 2024 - dhjetor 2025).
- Realizuar verifikimi në terren i “hotspoteve” për krijimin e hartës bazë të shkallës 1:2000, dhe përpunimi i informacionit hartografik, për zonat periferike (zona periferike Tiranë - Durrës: 98.0 km²), në proces është zona Maminas – Metallë 19 km², qyteti i Përmetit 5.5 km².
- Realizuar rilevimi 3D (fotogrametrik) për krijimin e hartës bazë të shkallës 1:2000, për zonat prioritare për zhvillimin ekonomik dhe turistik dhe përpunimi i informacionit hartografik të përfutur: (Tiranë zona veri - lindore dhe jugore: 13 km², zona bregdetare dhe veriore Durrës; 27 km², zona Maminas - Metallë Durrës; 19 km², qyteti i Përmetit: 5.5 km², qyteti i Belshit; 5.6 km²). Në total janë rilevuar 70.1 km². Në proces rilevimi janë zonat e qytetit të Prrenjasis: 7.1 km² dhe qyteti i Rrogozhinës: 5.7 km².
- Realizuar rilevimi Fotogrametrik 3D me metodën Niveli 2 i Detajeve për zonat e Kalasë së Beratit, Kalasë së Shkodrës, Kalasë së Krujës dhe Kalasë së Tepelenës.
- Realizuar monitorim dhe asistencë për funksionimin e rrjetit të stacioneve mareografike (Sarandë, Orikum, Durrës, Shëngjin), përgatitje dokumentacioni dhe realizimi i tenderit për blerje pajisje për mirëmbajtje, si dhe realizuar raportimi periodik. Në bashkëpunim me Komandën e Forcave Detare janë kryer riparime dhe zëvendësimi i pajisjeve të dëmtuara në stacionet mareografike të instaluar në vendbanimet Pashaliman (Orikum) dhe Shëngjin.
- Realizimi i projektit të prodhimit të ortofotos nga fotografimi historik i viti 1957. Informacioni është marrë nga arkiva e Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU), në proces mbetet publikimi i Ortoimazherisë në Gjeoportalin Kombëtar.
- Ndjekja e projektit "Përmirësimi i Sistemit të Gjeoportalit Kombëtar" dhe përgatitja mujore e dokumentacionit të nevojshëm për këtë proces. Janë kryer periodikisht proceset e Back-up dhe Restore të sistemit. Realizuar nga Operatori Ekonomik kërkesa e funksionalitetit të printimit me *vulë digjitale* në hartën e sistemit të Gjeoportalit Kombëtar.

- ASIG në bashkëpunim me Autoritetet Publike Përgjegjëse për temat e gjeoinformacionit, të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ka vazhduar procesin e përditësimit dhe harmonizimit me standardet shtetërore të të dhënave gjeohapësinore për tematikat:
 - Tema “Zonat e mbrojtura”, të dhënat për zonat e mbrojtura natyrore, të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.
 - Tema “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit”, të dhënat për rrjetet e monitorimit të mjedisit, për vitet 2020 dhe 2021, të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
 - Tema “Mbulesa e tokës”, të dhënat gjeohapësinore të projektit “Informacioni i integruar i pyjeve”, të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve.
 - Tema “Zonat me rreziqe natyrore”, të dhënat për Hartat e përmbytjeve për shtresat: Baseni Erzen, Baseni Ishëm, Baseni Vjosë, Baseni Seman, Baseni Shkumbin, të përgatitura nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.
 - Tema “Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare”, të dhënat gjeohapësinore për nën temën Rrjeti Broadband, të përgatitura nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
 - Tema “Burimet Minerare”, të dhënat për “Lejet Minerare të Shfrytëzimit”, të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Të dhënat e sipërcituara janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar duke e çuar në total 322 numrin e shtresave të gjeoinformacionit, të publikuara.

- ASIG në bashkëpunim me Autoritet Përgjegjëse po kryen hartëzimin e institucioneve publike. Deri më tani janë hartëzuar dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar:
 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Institucionet në varësi të MIE;
 - Drejtorite e Tatimeve;
 - Institucionet në Varësi të Ministrisë së Kulturës;
 - Posta Shqiptare;
 - Zyrat ADISA;
 - ADZM + ARM;
 - Sistemi i Drejtësisë: Sistemi Gjyqësor;

Në proces janë të dhënat për objektet e Arsimit, Shërbimit Shëndetësor, institucionet në varësi të pushtetit lokal, etj.

- ASIG në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe me 11 Bashkitë Bregdetare & Liqenore, në koordinimin e Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit , janë përgatitur Hartat e Stacionave të Plazheve për Sezonin Veror 2024.
- Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore në autoritetet publike për sektorin e gjeoinformacionit, ASIG ka iniciuar trajnime të stafëve teknike duke filluar nga

autoritetet publike përgjegjëse, për temat e gjeoinformacionit. Tematikat e trajtuara gjatë trajnimeve konsistojnë në:

- Përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar;
- Standardizimin e të dhënave gjeohapësinore sipas temave të gjeoinformacionit;
- Përmirësimin e proceseve të punës në institucionet përkatëse.

Gjatë viti 2023 janë realizuar trajnimet në:

- Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN);
- Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU);
- Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC);
- Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM);
- Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK);
- Institutin e Gjeoshkencave (IGJEO);
- Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT);
- Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK);
- Institutin e Transportit (IT);
- Agjencinë Kombëtare të Pyjeve;
- Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU);
- Shërbimin Hidrografik Shqiptar (SHSH);
- Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH);
- Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC);
- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
- Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT).

- Sipas parashikimit, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2023, janë miratuar:
 - Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit”. Miratuar me VKM-në nr. 210, datë 13.04.2023.
 - Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: “Habitatet”. Miratuar me VKM-në nr. 211, datë 13.04.2023.
 - Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: “Infrastruktura Industriale”. Miratuar me VKM-në nr. 212, datë 13.04.2023.
 - Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: “Zonat me përdorim të kufizuar”. Miratuar me VKM-në nr. 382, datë 29.06. 2023.
 - Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: “Shëndeti i njerëzve dhe siguria e tij”. Miratuar me VKM-në 383, datë 29.06. 2023.
 - Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: “Zonat ekologjike”. Miratuar me VKM-në nr. 571, datë 11.10. 2023.
 - Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: “Shpërndarja e specieve”. Miratuar me VKM-në 572, datë 11.10. 2023.

- “Standardet shtetërore të GIS-it Kombëtar”, Miratuar me VKM-në nr. 547, datë 28.09.2023.
- Është raportuar nga ana e ASIG në takimin Bilateral të Kapitullit 27, “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”, zhvilluar në Bruksel, në datat 19-23 qershor 2023, mbi përafrimin e legjislacionit dhe implementimin e Direktivës INSPIRE, 2007/2/EC, e përafuar nga ligji nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.
- Është realizuar lidhja e kontratës për website zyrtar www.asig.gov.al duke përmirësuar platformën e përdorur, si dhe është vijuar rregullisht me përditësimin e informacionit për website www.asig.gov.al, www.geoportal.asig.gov.al, www.krgjsh.asig.gov.al mbi aktivitetet e ASIG.
- ASIG është bërë anëtar i Rrjetit Copernicus Relay. Ky rrjet është krijuar nga Komisioni European si pjesë e Strategjisë Hapësinore për Evropën, me qëllim promovimin dhe përfitimin na programi i BE-së për vëzhgimin e Tokës Copernicus.
- Pjesmarrje aktive në aktivet e realizuar gjatë vitit 2023, si anëtar me të drejta të plota, në organizatën Eurogeographics.
- Në vijim të bashkëpunimit në kuadër të projektit SPATIAL II, i cili drejtohet nga Kadastra Hollandeze, ASIG mori pjesë në workshop-in me temë: “Vlerësimi masiv i pronave të paluajtshme dhe regjistri i çmimeve të shitjes”.
- Janë realizuar 2 mbledhje të Bordit të Informacionit Gjeohapësinor (BIG), ku ASIG ka rolin e sekretariatit teknik, në të cilën janë trajtuar tematikat e mëposhtme:
 - Nismat dhe projektet e autoriteteve publike përgjegjëse në sektorin e gjeoinformacionit, për vitin 2023;
 - Ndryshimet me VKM-në nr. 863, datë 27.12.2022 të VKM-së nr. 147, datë 20.02.2013, “Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, për përgjegjësitë e ASIG lidhur me përpunimin e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë, etj;
 - Të dhënat dhe shërbimet që ofrohen nga Gjeoportali Kombëtar pas realizimit të projektit “Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar”. Trajtimi i nevojave për trajnime nga autoritetet publike përgjegjëse dhe hartimi i një plani trajnimesh për vitin 2023.
 - Prezantimi i strukturës së re të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG).
 - Prezantimi dhe miratimi i dokumentit “Standardet Shtetërore të GIS-it Kombëtar”.
 -

- Aplikime të ASIG në projektet me donatore ndërkombëtarë:
 - For development of WEBGIS for smart land management in Albania
 - Orama4All
 - Observatory for building climate-related risk resilience in Adriatic marginal mountainous areas and mitigate risk and disasters for all

II. Problematikat e evidentuara

Gjatë realizimit të objektivave për vitin 2023, ASIG ka evidentuar problematikat dhe nevojat si më poshtë:

- Kërkohej shërbim konsulence për krijimin e modeleve nepermjet perdorimit te Intiligjencës Artificiale ne kuader te projektit “Shërbime Satelitore” për Monitorimin e Territorit me Teknologji të Avancuar.
- Sigurimi i buxhetit të nevojshëm për investime në realizimin e projekteve thelbësor për:
 - Ndërtimin e Infrastrukturës për të mbështetur veprimtarinë e Drejtorisë së Përpunimit të Informacionit të Territorit me Teknologji të Avancuar;
 - Vazhdimin e projektit të suksesshëm të fotografimit ajror me teknologjinë UAV, mjaft i rëndësishëm sepse përdorimi i teknologjisë UAV parashikon një mbulim të territorit të Republikës së Shqipërisë me fotografim, me rezolucion të lartë për krijimin e hartave bazë imazherike. Realizimi i këtij qëllimi është në përputhje me aktivitetin kryesor të ASIG, si përgjegjës për temën “Ortoimazheria”, si dhe në mbështetje të institucioneve përgjegjëse për monitorimin e territorit.
 - Realizimin e projektit të fotografimit 360° në rrugët kombëtare dhe zonat urbane i vlefshëm për krijimin e databazës imazherike, të tillë mund të realizohen me efektivitet të lartë dhe me kosto të ulët:
 - Kontrolli i mirëmbajtjes së akseve rrugore, të cilat i janë kontraktuar operatorëve ekonomikë;
 - Kontrolli i investimeve të kryera në akse rrugore (sinjalistikë, gjelbërim, ndriçim, etj);
 - Përcaktimi i zonave që kërkojnë ndërhyrje në kuadër të mirëmbajtjes;
 - Përcaktimi i investimeve në akset rrugore, në të cilat nuk janë kryer investime.
- Mungesa e një fotografimi të ri ajror, pengon prodhimin e hartës bazë të azhurnuar sipas viteve të fundit. Aktualisht po punohet në përcaktimin e “hotspoteve”, ku janë evidentuar ndryshime dhe grupet e punës po kryejnë azhurnimet në terren. Kjo metode vështirëson punën dhe ul rendimentin e prodhimit hartografik.
- Mungesa e financimit të projektit të krijimit të hartës bazë të shkallës 1:2000, vonon mbulimin e gjithë territorit me këtë hartë.
- Moszbatimi nga ana e Autoriteteve publike përgjegjëse për temat e gjeoinformacionit në ligjin 72/2012, për informimin dhe dërgimin e nismave të projekteve për Gjeoinformacionin në zbatim të VKM-së Nr. 451, datë 3.7.2019, "Për Rregullat Uniforme të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor".

- Në lidhje me projektin e hartëzimit të institucioneve publike, i cili po realizohet nga ASIG, kërkohet bashkëpunimi me Ministrinë dhe Institucionet e Varësisë. Të dhënat janë të rëndësishme sepse: a) janë pjesë e bazës së të dhënave të sistemit të Adresave (pika interesi); b) shërbejnë si të dhëna bazë për projekte që kanë lidhje me planifikimin e investimeve për fusha të ndryshme si Shërbime Publike, Emergjencë Civile, Konektiviteti, Statistika, etj.
- Mungesë ndërveprimi ndërmjet sistemeve GIS në institucionet publike me Gjeoportalin Kombëtar. Mos zbatimi i standardeve të Gjeoinformacionit, përdorimi i të dhënave jo zyrtare, mosvendosja në dispozicion të ASIG i të dhënave gjeohapësinore.

III. Objektivat Viti 2024

- Ndjekja e implementimit të projektit “Për realizimin e “Shërbimit Satelitor” për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë”.
 - Kontrolli dhe pranimi i produkteve të shërbimit satelitor sipas urdhrin nr. 134, datë 22.06.2023
 - Krijimi dhe përditësimi i shërbimeve të produkteve të projektit "Shërbimi Satelitor"
 - Krijimi i hartave tematike për produktet e projektit të "Shërbimi Satelitor" në funksion të plotësimit të kërkesave të institucioneve shqiptare sipas zonave të tyre të interesit:
 - Ortofoto me imazhet satelitore për territorin e RSh
 - Identifikimin e ndërtesave dhe ndryshimet e tyre
 - Identifikimi i serave
 - Identifikimi i sipërfaqeve pyjore dhe ndryshimet e tyre në kohë
 - Harta tematike Mbulesa e Tokës
 - Identifikim i sipërfaqeve ujore si dhe ndryshimet e tyre në kohë
 - Hartë tematike për indeksin e shëndetit të bimësisë
 - Hartë tematike për ndeksun e cilësisë së ujit
 - Hartë tematike për ndeksun e cilësisë së tokës
- Ndjekja e implementimit të projekteve që lidhen me mbledhjen e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet teknologjisë UAV dhe fotografimit me kamera "Street View 360°".
- Bashkëpunim me ministrinë apo institucionet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe hartimin e manualeve dhe udhëzimeve të nevojshme për mënyrën e përdorimit të informacionit të përftuar nga monitorimi i territorit me teknologji të avancuar.
- Takime me autoritetet publike përgjegjëse në lidhje me ecurinë e implementimit të projektit “Monitorimi i territorit me teknologji të avancuar”
- Realizimi i Projektit “Ndërtimi i Kornizës Referuese Gjeodezike, FAZA IV”, i cili ka si qëllim implementimin e rrejtës gravimetrikë të rendit III dhe realizimin e linjave të nivelimit të klasit të parë me saktësi të lartë për mbështetjen e të gjitha punimeve gjeodezike, inxhinierike dhe shkencore.
- Ndërtimi i sistemit të GIS Kombëtar. Hartimi i specifikimeve teknike dhe ndjekja e projektit për ndërtimin e sistemit të GIS Kombëtar.

- Realizimi i mirëmbajtjes së Gjeoportalit Kombëtar. Hartimi i specifikimeve teknike të mirëmbajtjes për periudhën 2024-2026.
- Ndërverprimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar me sistemet GIS :
 - Planifikimi i Territorit – AKPT
 - Sistemi i Adresave – DPGJC
 - Sistemi i Informacionit për Tokën Bujqësore – QTTB
- Ndjekja e Projektit “Mirëmbajtja e Rrjetit Gjeodezik ALBCORS”. Monitorrimi dhe kontrolli i funksionimit të ALBCORS.
- Menaxhimi dhe monitorimi i qendrës së rrjetit të stacioneve Mareografike. Realizimi i matjeve GNSS në pikat e kontrollit të stacioneve Mareografike.
- Prodhimi i Hartës Bazë Topografike shkalla 1 : 2000. Planifikohet të realizohet rievimi fotogrametrik 3D në qytet: Vlorë, Peqin, Gramsh, Divjakë, Kavajë, Lushnje, Berat, Kuçovë, Burrel, Elbasan, Përrenjas dhe Rogozhinë.
- Prodhim i Ortofotos Historike nga fotografimet ajrore të viteve 1970. Hartimi i specifikimeve teknike, ndjekja e projektit dhe përgatitja e të dhënave për publikim në Gjeoportalin Kombëtar.
- Përgatitja e informacionit gjeohapësinor për publikim në Gjeoportalin Kombëtar. Planifikuar për vitin 2024; Publikimi i të dhënave gjeohapësinore për tematikat Harta Bazë Topografike 1:2000; Institucionet Publike; Rrjetet e Transportit; Të dhënat nga Projekti Shërbime Satelitore; Ortofoto Historike Viti 1957; Korniza Referuese Gjeodezike, nëntema Rrjeti Gravimetrik (Gjeoid).
- Koordinimi me Institucionet Publike për përmirësimin e Infrastrukturës së Gjeoinformacionit në Republikën e Shqipërisë. Përmirësimi i cilësisë së të dhënave gjeohapësinore, të cilat administrohen nga Autoritet Publike Përgjegjëse. Planifikuar harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore ekzistuese, konform standardeve të Gjeoinformacionit për temat:
 - "Zonat e Mbrojtura", Nëntema ZM. Kulture (IMK);
 - Sistemi i Adresave (DPGJC);
 - Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit (AKM);
 - Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare (ASIG);
 - Pedologjia (QTTB);
 - Zonat me Rreziqe natyrore (AKMC).
- Trajnimi i stafeve të 61 Bashkive mbi përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar, standardeve të Gjeoinformacionit dhe projektin e Shërbimeve Satelitore.
- Asistencë teknike në institucione:
 - MTM për Hartën e Stacioneve të Plazheve;
 - Stafet përgjegjëse të Bashkive për përmirësimin e kufijve administrativë Rendi 4 (Njësitë Administrative) dhe Rendi 5 (Fshatra);
 - Stafet teknike në ARRSH, Institutin e Transportit dhe Bashki për përmirësimin e të dhënave për temën: "Rrjetet e Transportit --Transporti Rrugor;
 - Komitetit Kombëtar të Digave mbi përmirësimin e të dhënave gjeohapësinore për Digat e Mëdha.
- Bashkëpunimi me Autoritetet Hartografike Ndërkombëtare:
 - Pjesëmarrja dhe kontributi në Projektin SPATIAL;
 - Pjesëmarrja dhe kontributi në Projektin INGEST Task Force;
 - Ndjekja e takimeve të Grupit Teknik për INSPIRE MIG-T;

- Ndjekja e projektit me Eurogeografik "OME2 national large-scale data collection";
- Ndjekja e projektit "1st call of the Programme INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC 2021-2027 (SKEYE)"
- Përgatitja dhe dërgimi, për propozim për miratim në Këshillin e Ministrave, i paketës së akteve për miratimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"
- Përgatitja dhe dërgimi për propozim për miratim në Këshillin e Ministrave, i paketës së akteve për miratimin e projektvendimit "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor".
- Organizimi i mbledhjeve Bordit për Informacionin Gjeohapësinor (BIG).
- Ngritja e strukturës trajnuese në ASIG me qëllim rritjen e kapaciteteve në sektorin e Gjeoinformacionit.